



BQK publikoi statistikat për sektorin financiar për muajin maj 2014 dhe sektorin e jashtëm për tremujorin e parë të vitit 2014

Kumtesë për shtyp
30 qershor 2014

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës publikoi statistikat e sektorit financiar me të dhënat për muajin maj 2014, si dhe statistikat e sektorit të jashtëm me të dhënat për tremujorin e parë 2014. Të dhënat janë publikuar në kuadër të [Serive Kohore](#) në faqen e internetit të BQK-së sipas kalendarit të publikimeve t+25 për sektorin financiar dhe t+90 për sektorin e jashtëm.

Statistikat financiare ndër të tjera përfshijnë pasqyrat e korporatave financiare, bilancin e gjendjes së BQK-së, bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit të bankave komerciale, vlerën e kredive dhe depozitave, normat e interesit për kredi dhe depozita, pasqyrat financiare të korporatave tjera financiare, etj. Statistikat e sektorit të jashtëm përfshijnë statistikat e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare si dhe statistikat e borxhit të jashtëm të Kosovës.

Për më shumë, të dhënat e publikuara janë konform standardeve statistikore ndërkombëtare me një shkallë të lartë të krahasueshmërisë. Këto informata njëkohësisht publikohen në FMN në publikimin “Statistikat Financiare Ndërkombëtare” (anglisht: International Financial Statistics – IFS) dhe në Bankë Botërore (anglisht: Quarterly External Debt Statistics – QEDS).

BQK njofton të gjithë se që nga shtatori 2014, statistikat e bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare do të publikohen sipas metodologjisë së re, të rekomanduar me Manualin e Ri për *Bilancin e Pagesave dhe Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare (BPM6)*. Publikimi bëhet njëkohësisht me vendet anëtare të Bashkimit Europian, të cilat kanë marrë vendim që statistikat e bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare të publikohen sipas kësaj metodologjie. BQK-ja paraprakisht do të publikojë informatat e nevojshme lidhur me kalimin në metodologjinë e re.

Më poshtë është dhënë një pasqyrë e përmbledhur, që karakterizon statistikat e sektorit financiar për muajin maj 2014 dhe statistikat e sektorit të jashtëm për tremujorin e parë 2014. Në fund është paraqitur edhe një shtojcë statistikore lidhur me komponentët kryesorë të statistikave të sektorit financiar dhe sektorit të jashtëm.

SEKTORI FINANCIAR

Bilanci i gjendjes i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Më 31 maj 2014, gjithsej asetet e BQK-së arritën vlerën 1.59 miliard euro duke shënuar një rritje prej 109.7 milionë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja i atribuohet kryesisht rritjes së depozitave nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) në BQK për këtë periudhë. Investimet e BQK-së jashtë vendi në formë të depozitave dhe letrave me vlerë në fund të muajit maj ishin 1.44 miliard euro dhe kanë shënuar një rritje prej 121.7 milionë euro (9.2 përqind) në krahasim me muajin maj 2013. Gjatë muajit maj 2014 ka pasur ndryshime në strukturën e investimeve të BQK-së jashtë vendi; janë rritur investimet në letra me vlerë kurse janë zvogëluar investimet në depozita. Investimet në depozita jashtë vendi, në fund të muajit maj 2014, shënuan vlerën 807.1 milionë euro krahasuar me 935.4 milionë euro sa ishin në muajin maj 2013. Investimet në letra me vlerë arritën vlerën 630.9 milionë euro nga 380.9 milionë euro sa ishin në maj 2013.

Bankat komerciale, në fund të muajit maj 2014, kanë zvogëluar depozitat me BQK-në për rreth 45 milionë euro, kurse depozitat e institucioneve të tjera financiare në BQK në përgjithësi kanë mbetur në nivelin e njëjtë me atë të muajit maj 2013.

Bilanci i gjendjes së bankave komerciale

Asetet e bankave komerciale në fund të majit 2014 kanë arritur vlerën 3.04 miliardë euro duke shënuar një rritje vjetore prej 7.6 përqind. Në kuadër të aseteve, bilanci i bankave komerciale me BQK-në është zvogëluar për rreth 45 milionë euro. Bruto kreditë e bankave komerciale përafërsisht kishin nivel të njëjtë me vitin paraprak. Vlera e kredive ishte 1.86 miliard euro ose rreth 2.6 përqind më e lartë se në maj 2013. Investimet e bankave komerciale jashtë vendi në muajin maj arritën vlerën 633.6 milionë euro apo rritje vjetore prej 172.5 milionë euro.


Depozitat e klientëve në bankat komerciale në muajin maj 2014 shënuan vlerën 2.42 miliardë euro. Rreth 43.0 përqind e depozitave janë të afatizuara. Raporti i kredive ndaj depozitave mbetet në nivelin 77 përqind (79 përqind në maj 2013). Huamarrjet e bankave, detyrimet e tjera dhe provizionet për kredi të gjitha së bashku janë rritur për 37 milionë krahasuar me muajin maj 2013. Neto fitimi i bankave komerciale në Kosovë në pesë muajt e parë të 2014 shënoi vlerën 19.4 milionë euro (11.4 milionë euro ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Kapitali i bankave komerciale në fund të muajit maj 2014 ishte në 282.5 milionë euro, e që është nivel i përrreth 5 mil më i ulët me atë të muajit maj 2013.

Normat e interesit në kredi dhe depozita

Në muajin maj 2014 normat e interesit në depozita kanë shënuar rënie për 2.9 pikë-përqindje krahasuar me muajin maj të vitit paraprak. Në mesatare norma e interesit në depozita për muajin maj 2014 ka qenë 0.6 përqind. Edhe norma e interesit në kredi që ofrojnë bankat komerciale ka shënuar rënie në 12 muajt e fundit. Në mesatare, norma e interesit për muajin maj 2014 ka qenë 10.5 përqind (12.3 përqind ishte në maj 2013).

Në anën tjetër, normat e interesit në kredi të aplikuara nga institucionet mikrofinanciare gjatë muajit maj 2014 kanë shënuar ngritje të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Norma mesatare e interesit në kredi në maj 2014 ishte 23.2 përqind (22.1 përqind në maj 2013). Ngritja në mesatare të përgjithshme erdhi si rezultat i rritjes së normave të interesit për ekonomitë familjare nga 22.3 në 25.5 përqind në maj 2014. Pjesëmarrja e ekonomive familjare në gjithsej kreditë e reja për muajin maj 2014 ishte 65 përqind.

Figura 1 . Norma e interesit në kredi dhe depozita




¹ Normat e interesit në kredi nga institucionet mikrofinanciare kanë filluar të përpilohen për herë të parë nga janari 2012

SEKTORI I JASHTËM

Bilanci i pagesave të Kosovës

Deficiti i llogarisë rrjedhëse në tremujorin e parë të vitit 2014 shënoi vlerën prej 36.8 milionë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak deficiti është rritur për 23.4 milionë euro. Kontribuuesi kryesor i deficitit të llogarisë rrjedhëse mbetet kategoria e mallrave që në këtë periudhë arriti vlerën 392.0 milionë euro, duke shënuar një rënie të vogël prej 2.3 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, kontribuuesit kryesor në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse janë transferet rrjedhëse (259.7 milion euro), shërbimet (63.2 milionë euro) dhe të ardhurat (32.4 milionë euro). Në kuadër të transfereve rrjedhëse, dërgesat e emigrantëve në Kosovë në tremujorin e parë shënuan vlerën prej 130.8 milionë euro, që është për 3 milionë më e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Investimet e huaja direkte (IHD) në Kosovë në tremujorin e parë të vitit 2014 kanë shënuar rënie krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlera e IHD-ve në tremujorin e parë 2014 është 39.5 milionë euro ose për 20.8 milionë më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Niveli më i ulët i IHD-ve në këtë tremujor krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak erdhi si rezultat i investimeve më të ulëta në formë ekuiteti, rënies së lehtë të fitimit të ri-investuar si dhe kthimit më të lartë të kredive ndaj kompanive investuese. Bilanci i investimeve në letra me vlerë, pa përfshirë letrat me vlerë që bëjnë pjesë në kuadër të aseteve rezervë, gjatë këtij tremujori është rritur për 50.2 milionë euro. Në anën tjetër, rezervat ndërkombëtare në tremujorin e parë 2014 janë zvogëluar për 6.2 milionë euro.


Figura 2. Deficiti i llogarisë rrjedhëse, në milion euro



Pozicioni i investimeve ndërkombëtare

Kosova vazhdon të regjistrojë bilanc pozitiv të pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN) i cili në fund të tremujorit të parë të vitit 2014 ishte 434.2 milionë euro (400.4 milionë euro ishte në fund të dhjetorit 2013). Krahasuar me tremujorin paraprak, asetet e jashtme kanë shënuar rritje për 59.2 milionë duke shënuar vlerën 4.15 miliardë euro. Ndërkohë që edhe detyrimet ndërkombëtare kanë shënuar një rritje prej 25.4 milionë euro, duke shënuar vlerën 3.72 miliardë euro në fund të tremujorit të parë të vitit 2014. Rritjes së detyrimeve të huaja më së shumti i ka kontribuar rritja e investimeve të huaja direkte në Kosovë (rreth 40.1 milionë euro).


Figura 3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare, gjendja në fund të periudhës në miliard euro



Borxhi i jashtëm i Kosovës

Borxhi i jashtëm bruto i Kosovës, i cili përfshin borxhin publik dhe borxhin privat, në fund të marsit 2014 mbeti pothuajse në nivelin e njëjtë me tremujorin paraprak. Vlera e borxhit të jashtëm bruto më 31 mars 2014 shënoi vlerën 1.58 miliardë euro. Borxhi publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm (rreth 24 përqind), gjendja e të cilit në fund të marsit ishte 379.6 milionë euro. Pjesa më e madhe e borxhit publik përbëhet nga borxhi i jashtëm i qeverisë, i cili në fund të marsit 2014 ishte 317.4 milionë euro. Kjo vlerë është për 4.4 milionë euro më e vogël krahasuar me dhjetor 2013 dhe kryesisht i atribuohet pagesës së kredisë në kuadër të Programit Stand-By me FMN-në (SBA) dhe kredisë ndaj Bankës Botërore.

Figura 4. Borxhi i jashtëm bruto, gjendja në fund të periudhës në miliard euro²



Borxhi i sektorit privat në fund të muajit mars 2014 shënoi vlerën prej 1,201.9 milionë euro. Pjesa më e madhe e borxhit privat është në formë të kredive ndërmjet kompanive që janë në relacion të investimeve direkte (674.6 milionë euro), pasuar nga sektorët e tjerë të ekonomisë (302.1 milionë euro) dhe huamarrjet e bankave komerciale (225.2 milionë euro). Në kuadër të sektorëve tjerë bëjnë pjesë institucionet financiare jobankare, korporatat jofinanciare, organizatat joqeveritare dhe ekonomitë familjare. Në këtë kategori, dominojnë kreditë tregtare të korporatave jofinanciare që importojnë mallrave (121.1 milionë euro).

² Në kuadër të borxhit publik është përfshirë edhe Alokimi i SDR-ve nga FMN-ja, konform standardeve ndërkombëtare.

Shtojca statistikore

Tabela 1. Bilanci i gjendjes i BQK-së
(Në milion euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2013								2014				
	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nen	Dhj	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj
ASETET													
DST-të	62.3	61.9	61.4	61.3	60.7	60.4	60.2	59.6	60.3	59.5	59.5	59.5	59.8
Paraja e gatshme	29.1	39.3	34.0	66.4	34.8	41.7	29.5	27.4	42.9	26.5	28.8	32.7	20.2
Depozitat	935.4	813.5	899.9	758.3	730.8	1,008.2	1,076.0	890.9	842.4	860.6	828.7	799.4	807.1
Depozitat e transferueshme	89.5	62.2	50.4	20.8	15.3	109.0	18.9	55.8	48.5	4.8	2.5	5.7	24.4
Depozitat tjerë (të afatizuar dhe në llogari të kursimeve)	845.9	751.2	849.5	737.5	715.5	899.2	1,057.1	835.1	793.9	855.7	826.2	793.7	782.7
Letrat me vlerë përveç aksioneve	380.9	495.8	435.9	594.9	654.9	521.9	421.0	560.8	660.8	630.9	630.9	645.9	630.9
Llogaritë tjera të arkëtueshme	0.2	0.9	0.6	0.4	0.9	0.6	1.1	1.6	1.2	0.3	1.1	1.2	0.7
IMF Quota	68.2	67.8	67.3	67.4	66.8	66.5	66.6	65.9	66.7	66.1	66.2	66.2	66.8
Asetet jofinanciare	2.8	2.4	2.9	2.9	3.0	3.2	3.2	3.2	3.2	3.2	3.2	3.3	3.3
Asete gjithsej	1,479.0	1,481.7	1,502.0	1,551.6	1,551.8	1,702.5	1,657.6	1,609.4	1,677.6	1,647.0	1,618.5	1,608.2	1,588.7
DETYRIMET DHE KAPITALI													
Detyrimet													
KTD-të (Bankat)	273.9	254.6	271.5	335.1	318.5	340.3	357.3	327.8	323.0	293.4	255.7	245.1	228.7
Kompanitë e sigurimeve & Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve	4.0	4.0	4.1	4.9	4.8	4.8	4.7	5.0	5.0	4.8	5.0	5.0	5.0
Sektori publik	923.2	945.3	949.9	935.1	952.5	1,082.2	1,022.4	1,007.6	1,079.8	1,083.0	1,091.0	1,091.1	1,090.1
Agjencia Kosovare e Privatizimit	568.0	565.6	567.1	566.8	568.4	569.1	572.2	550.3	552.9	553.4	544.5	545.9	545.8
Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK)	7.2	14.6	9.8	11.0	14.4	142.2	138.5	209.7	202.1	215.9	225.6	235.1	258.1
Korporatat publike jofinanciare	22.6	22.4	22.9	22.4	24.3	24.7	24.7	24.6	53.4	56.5	55.4	51.9	45.8
Kuota në FMN (25% e kuotës)	16.7	16.6	16.4	16.5	16.3	16.3	16.3	16.1	16.3	16.2	16.2	16.2	16.3
Depozitët e Qeverisë qendrore	308.7	326.1	333.7	318.4	329.1	329.8	270.7	206.8	255.1	241.1	249.2	242.0	224.1
Alokimi i DST-ve	64.0	63.7	63.1	63.3	62.7	62.4	62.5	61.9	62.6	62.0	62.1	62.1	62.7
Llogaria me FMN	163.7	163.7	163.7	163.7	163.7	163.7	161.0	155.8	155.8	153.2	153.6	153.6	150.8
Llogaria e pagueshme	0.2	0.4	0.4	0.3	0.5	0.4	0.3	0.8	0.4	0.2	0.1	0.4	0.3
Kapitali													
Kapitali dhe të ngjajshme	49.9	49.9	49.3	49.2	49.1	48.7	49.4	50.5	51.0	50.4	51.0	50.8	51.2
prej të cilave: Fitimi / humbja gjatë vitit	-0.4	-0.4	-1.0	-1.1	-1.2	-1.5	-0.8	0.2	0.5	-0.1	0.6	0.4	0.8
Detyrimet dhe kapitali gjithsej	1,479.0	1,481.7	1,502.0	1,551.6	1,551.8	1,702.5	1,657.6	1,609.4	1,677.6	1,647.0	1,618.5	1,608.2	1,588.7

Tabela 2. Bilanci i gjendjes i bankave komerciale

(Në milion euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2013								2014				
	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj
ASETET													
Paraja e gatshme	106.3	101.3	131.8	120.8	114.5	113.1	111.7	130.6	109.0	104.6	112.0	112.7	109.9
Bilanci me BQK	273.5	254.1	270.8	334.2	323.8	339.7	356.8	332.8	322.7	293.4	255.7	244.7	228.7
Bilanci me Bankat komerciale	292.9	261.4	294.3	349.3	328.4	333.6	332.0	339.9	383.6	397.2	384.8	355.5	360.8
Letrat me vlerë	246.7	246.3	249.8	273.8	276.0	271.7	278.1	354.5	355.1	373.2	392.7	397.4	397.4
Kreditë bruto	1,810.0	1,825.7	1,816.0	1,790.1	1,798.0	1,798.8	1,803.2	1,805.8	1,794.5	1,794.3	1,825.9	1,839.7	1,856.8
Asete tjera	95.9	98.2	97.4	99.8	94.8	95.0	95.1	95.8	83.7	82.5	82.3	88.3	87.5
Asetet gjithsej	2,825.3	2,787.0	2,860.1	2,968.0	2,935.4	2,952.0	2,976.7	3,059.3	3,048.5	3,045.1	3,053.3	3,038.3	3,041.0
DETYRIMET DHE KAPITALI													
Detyrimet	2,538.1	2,514.0	2,584.4	2,691.4	2,662.9	2,675.2	2,702.0	2,781.4	2,767.8	2,761.9	2,765.6	2,762.8	2,758.6
Bilanci nga bankat komerciale	10.6	20.2	6.9	6.4	9.8	11.5	15.1	16.5	21.3	21.3	21.6	23.1	25.7
Depozitat:	2,247.0	2,201.3	2,271.2	2,370.9	2,344.7	2,354.6	2,359.2	2,449.0	2,443.4	2,433.4	2,430.8	2,425.9	2,415.1
Transferueshme	776.6	745.3	779.7	867.8	826.6	828.4	833.1	900.8	887.4	890.7	910.4	920.0	926.7
Kursimit	374.3	369.2	374.5	383.1	383.2	385.4	390.5	404.2	421.7	428.8	435.0	443.0	453.2
Afatizuara	1,096.2	1,086.8	1,117.0	1,120.1	1,134.9	1,140.7	1,135.5	1,144.0	1,134.4	1,113.8	1,085.4	1,062.9	1,035.1
Humarrjet tjera	48.6	51.1	66.6	67.7	67.1	67.1	66.9	69.8	69.6	70.2	69.7	70.9	71.8
Detyrimet tjera	73.8	83.8	77.9	79.7	76.1	75.4	89.6	74.7	60.1	61.8	65.6	61.7	66.0
Provizionet për kredi	158.1	157.5	161.8	166.8	165.1	166.6	171.2	171.5	173.4	175.2	177.9	181.2	180.0
Kapitali	287.2	272.9	275.8	276.6	272.5	276.8	274.7	277.8	280.8	283.2	287.6	275.5	282.5
Fitimi/humbja e vitit	11.4	16.2	18.1	19.0	22.4	25.7	23.6	25.9	2.9	5.4	9.8	12.5	19.4
Kapitali vetanak, rezervat & tjera	275.7	256.7	257.7	257.6	250.1	251.1	251.1	251.9	277.9	277.8	277.8	263.0	263.1
Detyrimet dhe kapitali gjithsej	2,825.3	2,787.0	2,860.1	2,968.0	2,935.4	2,952.0	2,976.7	3,059.3	3,048.5	3,045.1	3,053.3	3,038.3	3,041.0

Tabela 3. Normat e Interesit për Kredi dhe Depozita

(Norma e interesit në depozita dhe kredi të reja, në përqindje)

Përshkrimi	2013								2014				
	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj
BANKAT													
Depozitat													
Korporatat jofinanciare	3.6	3.6	2.5	2.3	2.6	2.2	3.0	1.2	2.6	1.1	0.5	0.3	0.5
Ekonomitë familjare	3.5	3.5	3.6	3.7	3.5	3.4	3.2	2.8	2.7	2.1	1.7	0.6	0.6
Mesatarja e ponderuar në depozita	3.5	3.5	3.6	3.4	3.4	3.3	3.2	2.4	2.7	2.0	1.7	0.6	0.6
Kreditë													
Korporatat jofinanciare	12.8	12.1	13.0	12.0	12.5	11.8	12.2	10.9	11.8	11.9	11.3	10.5	10.3
Ekonomitë familjare	11.7	11.9	12.2	12.0	11.6	11.6	12.3	11.4	11.6	11.7	11.1	11.1	10.7
Linjat kreditore-korp. jofinanciare	12.2	11.9	11.4	10.7	10.8	12.7	11.9	11.0	12.9	11.0	10.9	11.0	12.0
Mbitërheqjet -korp jofinanciare	10.7	10.3	9.3	10.8	10.1	10.5	9.4	9.4	8.8	8.8	9.8	9.4	9.9
Mbitërheqjet -ekonomitë familjare	15.5	13.2	14.3	16.6	15.8	16.4	15.9	14.4	14.6	13.8	14.6	14.0	11.8
Mesatarja e ponderuar në kredi	12.3	12.0	12.6	12.0	12.2	11.7	12.2	11.1	11.7	11.8	11.2	10.7	10.5
INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE													
Korporatat jofinanciare	20.3	20.8	20.6	22.3	21.7	21.4	20.1	19.8	21.4	16.0	18.4	20.8	18.9
Ekonomitë familjare	22.3	25.6	21.5	24.8	24.2	24.5	22.9	23.7	25.2	24.1	24.5	24.2	25.5
Mesatarja e ponderuar në kredi	22.1	24.8	21.4	24.3	24.0	23.9	22.5	22.6	24.7	23.3	24.1	23.8	23.2

Tabela 4. Bilanci i pagesave

(Në milion euro)

Përshkrimi	2012				2013				2014
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1
Llogaria rrjedhëse	-20.9	-120.9	-143.5	-94.9	-13.4	-117.5	-99.7	-108.8	-36.8
Mallrat	-372.9	-548.8	-612.0	-539.1	-389.7	-517.2	-550.7	-534.4	-392.0
Eksporti (f.o.b.)	61.5	78.9	72.0	74.6	71.8	84.4	75.9	73.0	68.1
Importi (f.o.b.)	-434.4	-627.7	-683.9	-613.7	-461.5	-601.6	-626.6	-607.4	-460.1
Shërbimet	47.4	81.4	129.3	88.1	59.5	78.3	122.7	47.8	63.2
Eksporti	106.6	147.0	227.3	154.2	104.6	146.9	237.1	133.4	124.1
Importi	-59.2	-65.5	-98.0	-66.1	-45.1	-68.6	-114.4	-85.6	-60.9
Të ardhurat	37.4	44.4	20.3	52.0	42.4	32.5	2.2	44.6	32.4
Kredi	59.4	58.3	56.4	56.5	57.3	55.4	55.5	59.6	49.3
Debi	-21.9	-13.9	-36.1	-4.5	-14.9	-22.9	-53.3	-15.0	-16.9
Transferet rrjedhëse	267.2	302.1	318.9	304.1	274.3	288.9	326.0	333.2	259.7
Kredi	293.5	328.2	345.2	329.5	294.4	309.4	346.6	353.6	278.6
Prejt të cilave: Remitancat	119.1	142.4	174.7	168.9	127.8	144.6	182.2	166.2	130.8
Debi	-26.3	-26.0	-26.4	-25.4	-20.0	-20.4	-20.6	-20.5	-18.9
Llogaria kapitale	-0.9	2.5	-1.7	13.0	10.6	3.1	9.7	11.4	3.4
Kredit	2.8	7.2	2.9	18.8	10.1	7.0	7.8	16.6	7.2
Debit	-3.7	-4.7	-4.5	-5.8	0.5	-3.9	2.4	-5.2	-3.8
Llogaria financiare	13.8	75.8	-26.0	66.7	-10.1	135.2	-61.0	59.3	-28.8
Investimet e huaja direkte	55.0	23.5	88.5	46.3	57.3	80.9	53.9	49.5	34.3
Jashtë vendit	-1.7	-6.4	-3.7	-3.9	-3.1	-2.6	-7.7	-4.6	-5.2
Në Kosovë	56.3	29.9	92.3	50.2	60.3	83.4	61.6	54.1	39.5
Investimet në letrat me vlerë	-80.8	37.0	-163.2	22.1	-53.5	-82.7	-91.8	87.7	-50.2
Asetet	-81.0	37.0	-163.2	21.5	-53.5	-81.7	-91.8	87.7	-50.2
Detyrimet	0.2	0.0	0.0	0.5	0.0	-1.0	0.0	0.0	0.0
Investimet e tjera	47.6	32.2	254.8	34.6	-20.1	151.7	46.2	-191.1	-19.0
Asetet	112.8	-27.4	107.7	-46.7	39.1	106.1	-33.1	-195.6	-2.7
Detyrimet	-65.2	59.6	147.1	81.3	-59.3	45.6	79.3	4.6	-16.2
Asetet rezervë	-8.0	-16.9	-206.2	-36.2	6.3	-14.6	-69.3	113.3	6.2
Gabimet dhe harresat	8.0	42.6	171.2	15.1	12.9	-20.9	151.0	38.2	62.1

Tabela 5. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare
(Në milion euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2012				2013				2014
	T1	T2	T3	T4	T1	T1	T3	T4	T1
PIN Neto	230.4	173.1	236.6	248.8	416.8	279.1	420.6	387.0	434.2
Asetet	3,344.0	3,352.7	3,634.0	3,705.1	3,857.1	3,845.1	4,067.9	4,083.4	4,149.7
Investimet direkte jashtë vendit	103.8	110.2	113.9	117.8	120.9	123.5	131.1	135.4	140.6
Investimet në portofolio	860.6	814.5	998.7	986.6	1,073.1	1,138.1	1,253.9	1,186.0	1,252.4
Letrat me vlerë të kapitalit	348.4	397.7	324.7	354.1	396.6	400.4	453.4	407.8	405.0
Letrat me vlerë të borxhit	512.3	416.8	674.0	632.5	676.5	737.6	800.5	778.2	847.4
Derivatet financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Investimet tjera	1,798.8	1,827.1	1,715.6	1,760.6	1,829.8	1,737.3	1,768.9	1,948.0	1,963.6
Kreditë tregtare	1.0	1.0	1.0	1.2	11.0	16.8	13.9	11.9	12.1
Kreditë	59.0	58.2	79.1	81.3	94.4	84.5	96.6	112.0	124.0
Paraja e gatshme dhe depozitat	1,734.7	1,763.1	1,633.3	1,673.9	1,721.3	1,631.8	1,655.9	1,820.1	1,823.0
Asetet tjera	4.1	4.9	2.1	4.3	3.1	4.3	2.5	4.0	4.5
Asetet rezervë	580.9	600.9	805.8	840.0	833.4	846.2	913.9	814.0	793.1
Detyrimet	3,113.6	3,179.6	3,397.3	3,456.3	3,440.4	3,566.0	3,647.2	3,696.4	3,715.5
Investimet direkte në Kosovë	2,368.3	2,385.3	2,472.5	2,524.3	2,582.4	2,664.8	2,725.7	2,774.0	2,807.8
Investimet portofolio	1.3	0.7	0.7	0.5	1.8	0.7	0.8	0.7	0.8
Letrat me vlerë të kapitalit	1.3	0.7	0.7	0.5	1.8	0.7	0.8	0.7	0.8
Letrat me vlerë të borxhit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Derivatet financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Investimet tjera	744.1	793.7	924.1	931.4	856.2	900.5	920.8	921.7	906.9
Kreditë tregtare	115.8	167.3	219.6	199.8	119.4	156.5	162.9	154.3	121.1
Kreditë	475.6	472.8	515.5	541.3	537.4	564.9	561.6	579.6	581.9
Paraja e gat. dhe depozitat	85.1	82.1	115.4	120.9	130.6	110.6	129.2	123.8	136.9
Detyrimet tjera	67.6	71.5	73.5	69.5	68.8	68.5	67.1	67.1	66.9

Tabela 6. Borxhi i jashtëm

(Në milion euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2012				2013				2014
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1
Borxhi Publik dhe Borxhi Publik i Garantuar	312.8	320.9	361.2	401.4	398.0	394.8	387.8	383.9	379.6
Qeveria	247.4	253.4	294.2	336.5	332.8	331.1	324.6	321.8	317.4
Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Afatgjatë	247.4	253.4	294.2	336.5	332.8	331.1	324.6	321.8	317.4
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	65.3	67.5	66.9	65.0	65.1	63.8	63.2	62.1	62.2
Afatshkurtër	1.1	0.7	0.9	0.4	0.3	0.1	0.3	0.3	0.1
Afatgjatë	64.2	66.7	66.0	64.6	64.8	63.7	62.9	61.9	62.1
Borxhi i Sektorit Privat i pagarrantuar	1,004.4	1,064.1	1,175.8	1,115.9	1,054.9	1,145.8	1,186.7	1,212.2	1,201.9
Bankat	162.1	151.0	184.1	175.6	185.8	184.3	206.8	208.1	225.2
Afatshkurtër	162.1	151.0	184.1	175.6	185.8	184.3	206.8	208.1	225.2
Afatgjatë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sektorët tjerë	269.2	321.8	378.9	354.4	272.5	324.1	326.2	329.7	302.1
Afatshkurtër	183.4	240.0	340.6	321.0	238.3	279.8	278.4	281.1	247.5
Afatgjatë	85.9	81.8	38.3	33.5	34.2	44.3	47.7	48.5	54.6
Investimet Direkte: Kreditimi ndërmjet kompanive	573.1	591.3	609.1	585.9	596.7	638.7	655.5	674.4	674.6
Gjithsej Borxhi i Jashtëm Bruto	1,317.2	1,385.0	1,533.2	1,517.3	1,452.9	1,539.2	1,576.3	1,596.1	1,581.5